



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Inter Adria" Sh.P.K. të datës 11.12.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 06.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje teknologjike (IT, shkencë) për kabinete në IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-9220-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Inter Adria" Sh.P.K. e datës 11.12.2023 kundër kundër njoftimit mbi vendimin e datës 06.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje teknologjike IT, shkencë) për kabinete në IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-9220-1-1-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 06.12.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Inter Adria" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik "Inter Adria" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 11.12.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 06.12.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje teknologjike IT, shkencë) për kabinete në IEAA" me nr. të prokurimit 616-23-9220-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë formuluar si në vijim "Pas ekzaminimit të ofertës të OE të shpallur fitues në kemi vërejtur se OE Aritech gjatë fazës së tenderimit ka dorëzuar broshurat për poz. 2 dhe 3 "Lenovo Legion T7 34IAZ7" dhe ka nënvizuar modelin e procesorit "Core i712700KF" respektivisht Core i912900KF" ndërsa pas kërkesës tuaj për sqarime OE i shpallur fitues ju ka deregulluar broshurat për modelin e PC për poz. 2 dhe 3 "Legion T7 34IRZ8" dhe ka nënvizuar modelet e procesoreve "Core i714700KF respektivisht Core i914900K" gjë që bie ndesh me LPP, pasi që OE nuk ka drejtë të ndryshojë produktet pasi hapjes së ofertave dhe vlersimit të tyre".

Lidhur me pretendimet e parashtruesit me rastin e administrimit të dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar dhe krahasimit të tyre me sqarimet shpesh të dërguara më vonë të autoriteti kontraktues është gjetur se specifikat e pajisjes në broshurë sikurse janë nënvizuar nga tenderuesi i rekomanduar dallojnë me specifikat e pajisjes në broshurë të nënvizuara me rastin e sqarimeve shpesh. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi ankimor i parashtruesit është pretendim i bazuar. Me rastin e procedurës së rivlerësimit, komisioni duhet të ekzaminojë, krahasojë dhe të verifikojë nëse tenderuesi i rekomanduar, bazuar në ato që u thanë më sipër, ka arritur që të përmbushë kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Në këtë mënyrë është gjetur se komisioni vlerësues nuk pra vepruar në përputhje me nenin 59 të LPP dhe 40 të RRPP. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 12.12.2023

Visar SHEHU  
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komandë Prishtinë



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.